



AKADEMIA ALTERNATIVE RRËNJËT TONA

IMAZHI SHQIPTAR

ILIRIKUM

Albania VALUE

Ai popull që nuk njeh të shkuarën e tij ngelet fëmijë nga ment.

KUVEND MBARËKOMBËTAR

**PËRPPJEKJET E SHQIPTARËVE PAS PAVARSISË DERI NË KUVENDIN E
LUSHNJES PËR TË FORMUAR BAZAT E SHTETIT TË SOTËM SHQIPTAR**

Lushnje, Ditë e martë, 21- 22 Janar, 2020, Muzeu Lushnje

Qarkullori i parë

Qëllimi: *“Rritja e vetëdijes së shqiptarëve mbi rëndësinë e njohjes së lidhjeve të historisë së tyre me ngjarjet thelbësore të vendit”*

Ideja: *Na duhet të njohim njerëzit dhe ngjarjet e shkuara për t'i analizuar dhe matur me peshoren e çështjes shqiptare, se çfarë prodhuan njerëzit si individë apo grupe shoqërore me sjelljen dhe mentalitetin e tyre të at'hershëm, në formimin e shtetit shqiptar.*

Në bashkëpunim me:

Ministritë e Arsimit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni),

Ministritë e Kulturës (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni),

Me mbështetje të:

Akademia e Shkencave Tiranë, Akademia e Shkencave Prishtinë, Universiteti i Tiranës,
Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Universiteti European i Tiranës,
Universiteti Luarasi, Albanian University.

PSE DUHET TË ORGANIZOJMË KUVENDIN

- PËRPIEKJET E SHQIPTARËVE PAS PAVARSISË DERI NË KUVENDIN E LUSHNJES PËR TË FORMUAR BAZAT E SHTETIT TË SOTËM SHQIPTAR?

Sepse:

1. Kuvendet si Kuvendi Kombëtar i Vlorës - u mbledh, në rrethanat e nevojës ekstreme, për të shpallur pavarësinë dhe për të ruajtur integritetin kombëtar dhe tërësinë e territoreve shqiptare. Natyra e tij kushtetuese ishte e kushtëzuar nga rrethanat e luftës për ekzistencë. Pas Shpalljes së Pavarësisë, aktet e tjera kushtetuese, në funksion të krijimit të strukturës së nevojshme shtetërore, që do të çertifikonin/mbështesnin ambicien shtetformuese të shprehur ndërkombëtarisht, ishin: formimi i Qeverisë (së Përkohshme), krijimi dhe zgjedhja e Pleqësisë (si organ mbështetës i qeverisë me funksione kontrolli dhe ndihmëse), si dhe krijimi dhe zgjedhja e Komisionit, i cili do të punonte në nivel përfaqësimi diplomatik.¹



Fig. – 1 Kushte e rrethanat që ndodhesh vendi ynë menjëherë pas shpalljes së pavarësisë

¹ Për më tepër shih: A. Anastasi, *Historia e të Drejtës Kushtetuese Shqiptare (1912-1939)*, Pegi, Tiranë,

2007, f. 16; L. Omari, *Sistemi Parlamentar; Lindja dhe Evolucioni i Parlamentarizmit; Parlamenti në Shqipëri*, Botimet Elena Gjika, 2000, f. 153 e vazhdim.

Në këto rrethana, shqiptarët, sot, do të duan të dinë shumë më tepër, dhe shumë më pranë të vërtetës për shkaqet që çuan në krijimin e një Traktati, i quajtur dhe i mbajtur i fshehtë, siç qe ai i Londrës.

Cilët qenë përfituesit dhe pasojat e realizimit të tij, kur dihet se mbas tetë muajsh, më 29 Korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër caktoi kufijtë e Shqipërisë, duke lënë jashtë trojeve etnike rreth 60% të territorit dhe dy të tretat e shqiptarëve, ku Shqiperia do të ishte për dhjetë vjet nën Mbikqyrjen e fuqive të mëdha nëpërmjet përfaqesuesve të tyre në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK).

2. Ardhja e Princ Vedit - Në ç'rethana erdhi? Si e gjeti dhe si e la Shqipërinë? Konfuzioni politik dhe social i shoqërisë shqiptare përgjatë kohës së shkurtër të mbretëritimit të tij



Fig. – 2 Ardhja e Princ Vedit v. 2014

3. Ç'përfaqësonte lëvizja Qamilliste. A mund të themi se ishte një lëvizje tipikisht fshatare, e grupuar, krahinore apo kthim dhe nostalgji për kohën e kaluar?

Fig. – 3 Përballja e vendit dhe përfundimi i lëvizjes anarkiste Dum Baba




4. Shqiptarët kanë uri të dinë, pse Shqipëria, megjithëse nuk kishte marrë

pjesë në luftën e parë botërore ishte shesh lufte, dhe përcaktuar për t'u ndarë, si plaçkë lufte dhe përfituesit e kësaj plaçke ishin në rradhët e fituesve të luftës si Italia, një nga katër fuqitë kryesore; Greqia, megjithëse ishte e rreshtuar me Antantën në verën e 1916

dhe Serbia, e cila me 01 Dhjetor 1918, vetëm njezetë ditë mbas mbarimit të luftës, e cila me mbështetjen e Antantës ishte bërë pjesë e Mbreterisë Serbe-Kroate-Slllovene.

Nga ana tjetër, ç'ishte kjo luftë e cila përfundoi në 11 Nëntor 1918 me fitoren e Antantës, pasojë e së cilës ishte rënia e katër perandorive, dy nga të cilat ajo Austro-Hungareze dhe Gjermane.

Fig. – 4 Të fortët dhe të fshehtit, duke vendosur copëtimin e shqipërisë në Konferencën e Londrës.



Pikërisht, dy perandoritë që kishin qënë baza për krijimin e shtetit shqiptar, që më pas fati i shqipërisë dhe i shqiptarëve ndodhej në fije të perit për ekzistencën e vet kombit.

5. Po cilët kanë qënë në fakt shkaqet kryesore të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore?

A ka qënë zhvillimi i pabarabartë ekonomik, rënia e Britanisë dhe Francës dhe dalja në krye e SHBA dhe Gjermanisë, ndryshim që çoi në luftë të ashpër për tregje dhe burime lëndësh të para. A mundën fuqitë e mëdha europiane t'i menaxhonin krizat, siç kishin bërë mbas luftimeve napoleoniane që nga Kongresi i Vjenës i 1815. Që në fakt, duke filluar nga Lufta e Parë Botërore, zbulimi i vendburimeve të naftës në shumë pjesë të tjera të botës pati një ndikim të madh në ekonomi dhe në politikë. A nuk duhet të zbulohen fakte sesi sigurimi i burimeve energjitike, sidomos të hidrokarbureve, ka përcaktuar gjeopolitikën dhe ndërtimin e strategjive afatgjata të fuqive të mëdha, si dhe ka qënë shkaku kryesor i rivaliteteve, konflikteve dhe luftimeve në planetin tonë. Në këto kushte anglo-saksonët vendosën që këto vendburime të pritshme të naftës t'i kontrollonin vetë.

6. Kuendi i Durrësit – i mbledhur nën pilotimin e hapur të interesave italiane, në dhjetor të vitit 1918 pavarësisht kontekstit nga i cili u frymëzua, arriti të formojë një qeveri të përkohshme, ashtu si bëri edhe Kuvendi i Vlorës, duke theksuar nevojën e fokusimit të dy prerogativave emergjente si marrjen nën kontroll të territorit shqiptar dhe rikonfirmimin e pavarësisë së tij, por që nuk u mund të arrihej dot.

7. A është e vërtetë se anglezëve iu duhej ndryshuar projekti në fuqi i traktatit të Londrës për Shqipërinë, që do të conte në copëtimin e saj. Një projekt i ri ishte hartuar nga aleatët anglo-saksonë dhe duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 1919, po punohej me angazhim maksimal për zbatimin e tij. Synimi i këtij projekti ishte që Shqipëria të ishte një shtet, me pavarësi të plotë në kufijtë e vendosur në 29 Korrik 1913 në Londër të rikonfirmuar nga ndërkombëtarët, në mënyrë që ajo të kishte sovranitet të plotë qeverisje mbi territorin dhe pasuritë e veta kombëtare. Këtij qëllimi do t'i shërbente mbajtja e Kongresit Mbarëkombëtar të Lushnjes, i cili do të duhej të miratonte Aktin Themeltar Kushtetues për Pavarësinë e Plotë të Shqipërisë, duke hedhur poshtë çdo përpjekje për cënimin e kufijve të saj, përpara se Konferenca e Paqes të shqyrtonte në mënyrë përfundimtare rastin e Shqipërisë në fillim të janarit 1920. Vonesa e mbajtjes së këtij Kongresi i detyroi anglezët që të bënin bashkëpunëtor, të projektit të tyre për Shqipërinë edhe francezët, të cilët kishin lidhje të vecanta me të gjithë përfituesit e projektit për copëtimin e Shqipërisë. Me këtë marrëveshje, Britania i dha mundësinë Francës të hyjë për herë të parë në tregun e naftës, gjë që e detyronte Francën të bëhej pjesë e projektit të ri anglo-sakson për Shqipërinë, duke hedhur poshtë Traktatin e Fshehtë të Londrës, që çonte në copëtimin e saj. Vetëm se këto fuqi fitimtare nuk mund të vepronin, si me rastin e Mesopotamisë së vjetër, ku kishin të bënin me një fuqi të mundur, Perandorinë Osmane. Në rastin e "Mesopotamisë së Re", ato do të duhej të anulonin një Traktat që vetë kishin formuluar dhe firmosur, duke prekur thelbësisht interesat e aleatëve që qëndronin krah tyre në Konferencën e Paqes.²

8. Ç'përbënte në thelb Konferenca e Paqes së Parisit e mbledhur nga 18 Janar 1919 deri në 21 Janar 1920 dhe roli i saj për njohjen e përpjekjeve të shqipëtarëve në formimin e shtetit të vet. Në kuadër të kësaj konference dhe në zbatim të Traktatit të Fshehtë të Londrës, u përpilua edhe marrëveshja për copëtimin e Shqipërisë midis Italisë dhe Greqisë, e firmosur në 29 korrik 1919 nga Titoni Venizellos. Sipas kësaj marrëveshje, Greqia morri pjesën jugore, Serbia dhe Mali i Zi pjesën veriore, Italia Ishullin e Sazanit dhe Vlorën me rrethinat, ndërsa në pjesën që mbetej do të krijohesh një principatë myslymane nën protektoratin e Italisë. Në fronin e kësaj principate pritej të ulej Esat Pashë Toptani, një nga personalitetet më të spikatura shqiptare të kohës, sidomos të dhjetëvjetëshit të dytë të fillim shekullit të njëzetë.

² Prof. Astrit Avdyllaj

Fig. – 5 Përsëri të fortët, por haptazi duke vendosur copëtimin dhe më në fund njohjen e shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes, pas Kuvendit të Lushnjës, 1919-1920.



Me origjinë nga një familje e pasur çifligare, gjeneral dhe deputet i Perandorisë Osmane, Ministër i Brendshëm në Qeverinë e Ismail Qemalit, si dhe Ministër i Brendshëm dhe i Luftës në Qeverinë e Princ Vedit, ai diti të orientohej drejt për interesat dhe ambiciet e tij, duke u rreshtuar me Antantën që fitoi luftën. Ai bashkëpunoi me Italinë, me Serbinë, Greqinë dhe Francën, duke kontribuar me një batalion luftëtarësh shqiptarë në kuadrin e armatës franceze në Selanik të Greqisë. Të gjitha gjasat e kohës tregonin se copëtimi i Shqipërisë dhe asgjësimi i pavarësisë së saj ishin të sigurt. Në rastin më të mirë shqiptarët do të kishin shtet një principatë - protektorat prej 12 mijë km², me në krye Esat Pashën, i cili do të ishte Heroi Kombëtar i shqiptarëve, meqe arriti t'u ruante atyre një copë Shqipërie!?

9. Cila ishte situata e shqipërisë në ditët e para të fillimvitit 1920? A ishte ajo, sikundër e përcakton fjala e Fan Nolit në Parlamentin shqiptar në 11 Shkurt 1924, në homazh të vdekjes së Presidentit amerikan Willson ku thot se: "Në Janar 1920, një ere zije dhe dëshperimi kish rënë në të gjithë anët e vendit, i cili qe si një i vdekur në agoni. Projekti i copëtimit të Shqipërisë, i redaktuar prej Aleatëve, ishte njohur dhe pritej vetëm një firmë që të bëhej një fakt definitiv. Firma që mungonte ishte ajo e presidentit Willson, firmë qe nuk u vu në atë projekt, aq të padrejtë. Presidenti Willson, jo vetëm nuk e vuri firmën, po u përgjegj edhe me dy nota, me të cilat mpronte të drejtën e Shqipërisë së vogël për vetëqeverim, dy nota që janë dy nga xhevahiret më të ndritshëm të karrierës së tij të shkëlqyer. Ato nota ndaluan copëtimin e Shqipërisë dhe na dhanë kohë të marrim frymë dhe të gatitim lirinë e Shqipërisë që gëzojmë sot... Dhe si u hoq nga fuqia Presidenti

Willson, kush e mori mprojtjen e Shqipërisë? Isht Lidhja e Kombeve, krijesa e Presidentit Willson.”

10. Kongresi i Lushnjës – ishte në fakt një Kuvend Kombëtar³ me karakter përfaqësues dhe plotësisht i ligjshëm për të ndërmarrë akte me karakter kushtetues, i cili mbarti të njëjtin nivel ambicieje për ngritjen reale të shtetit shqiptar, që shprehu Kuvendi i Vlorës dhe projektoi në sintoni me profilin e këtij të fundit funksione kushtetuese të mirëfillta.



Fig. – 6 Delegatët duke shkuar për në Kuvendin e Lushnjës.

Ndër to, më e rëndësishmja për nga këndvështrimi i fushës sonë të studimit, mbetet ajo e “formës së regjimit” që do të ushtrohej në shtetin shqiptar. Kongresi i Lushnjës u mbledh më 21 janar 1920. Në të u përfaqësuan të gjitha krahinat e Shqipërisë, me 50 përfaqësues. Ai zhvilloi punimet nga 28-31 janar 1920 dhe u vetëshpall i shpërndarë më 5 shkurt të po atij viti, duke i përcjellë kompetencat si Mbledhje/Asamble e Përgjithshme Kombëtare (Kuvend Kombëtar), Senatit të zgjedhur prej radhëve të tij, nga ai vetë. Kongresi dhe të gjitha organet kushtetuese të dala prej tij (për shkak të kushteve të emergjencës në të cilat ishte thirrur), kishin për qëllim garantimin e funksionimit të përkohshëm dhe transitor të shtetit, deri sa të mundësohej mbledhja e Asamblesë Kushtetuese, e cila do të sanksiononte përfundimisht vullnetin mbarëkombëtar mbi formën e organizimit të shtetit.

10.1 Pse mbas Kongresit të Lushnjës, u rrit fryma atdhetare dhe filluan organizimet për të bërë reale pavarësinë e Shqipërisë në të gjithë territorin e saj. Ndoshta, mbajtja e Kongresit Mbarëkombëtar të Lushnjës në 21-31 Janar 1920, miratoi Aktin Themeltar

³ Fenomene të ngjashme, prej lashtësisë, në vend, kishin/kanë marrë emrin e Kuvendeve. I tillë do të quhej edhe Kuvendi Kombëtar i Vlorës, edhe i durrësit, si edhe kjo e Lushnjës, pavarësisht më vonë mori formën dhe trajtesën si Kongres, por që nuk ka qenë kurrë i tillë.

Kushtetues për Pavarsinë e Plotë të Shqipërisë, duke hedhur poshtë çdo përpjekje për cënimin e kufijve të saj. Ndoshta, Kongresi zgjodhi Këshillin e Lartë prej 4 vetësh, në funksionin e Kryetarit të Shtetit, Këshillin Kombëtar prej 37 vetësh, Qeverinë me Kryeministër Sulejman Delvinën dhe caktoi kryeqytet Tiranën, mbasi quajti të rrëzuar Qeverinë e Durrësit,.

10.2 Cila ishte përgatitja dhe zhvillimi i Luftës së Vlorës për të larguar prej andej ushtrinë italiane, ku ndoshta duhet të dimë më shumë për rrethanat sesi luftëtarët nga krahina e Vlorës dhe nga shumë krahina të tjera të Shqipërisë, të mbështetur nga Qeveria e Tiranës, filluan sulmin mbi ushtrinë italiane në 05 Qershor 1920 dhe në 02 Gusht 1920 u nënshkrua Protokolli i Tiranës, ku Qeveria e Romës deklaronte se Respektonte sovranitetin shqiptar mbi Vlorën dhe tërësinë tokësore të Shqipërisë". Një muaj më vonë, trupat italiane ishin tërhequr nga Vlora. Kjo ishte një fitore e madhe, por edhe një mesazh për pretendimet territoriale të fqinjëve jugore dhe veriore.

10.3 A luftoi ky Kongres për dekurajimin, deligjitimimin dhe goditjen e perfituesve nga Traktari i fshehtë i Londrës që vazhdonin të kërkonin realizimin e tij, ku akti më domethënës ishte vrasja e Esat Pashë Toptanit, si dhe vendimi i Gjykatës Franceze që e shpallte Avni Rustemin të pafajshëm.

10.4 Cilat ishin përpjekjet, tashmë nga Qeveria shqiptare e dalë nga ky Kongres për pranimin në Lidhjen e Kombeve, e bërë në 12 Tetor 1920, e cila në 15 Nëntor 1920 do të mbledhej në Gjenevë, në të parën Asamble të saj, ku më 12 Nëntor 1920 mbriti delegacioni shqiptar i kryesuar nga Fan Noli, i cili filloi të plotësojë dokumentacionet e pranimit. Fakte sesi me mbështetjen që i bënë përfaqësues të vendeve, pjesë të Perandorisë Britanike, Shqipëria, në 17 Dhjetor 1920 u bë anëtare e 43 e Lidhjes së Kombeve, me 35 vota pro, 7 abstenime dhe asnjë votë kundër, çka përbënte ngjarjen më të madhe, mbasi tani për fatet e Shqipërisë nuk do të diskutohej dhe nuk do të të merreshin më vendime nëpër kulisa, por në institucione, ku do të debatohej dhe do të degjohej edhe emri i përfaqësuesve të saj.

10.5 A u realizuan këto arritje të vitit 1920 si të pashëmbullta në historinë e Shqipërisë si rezultat i një mobilizimi maksimal i të gjitha shtresave të shoqërisë, apo shqiptarët

kuptuan se ishin para çbërjes përgjithmonë të shtetit shqiptar. Megjithëse, pati një aktivizim maksimal të diasporës shqiptare në të gjitha fushat, në politikë, në luftë, në diplomaci, me shtyp dhe me ndihma të ndryshme. Ndoshta pse përputhja e interesave të momentit të fuqive të mëdha vendimarrëse të kohës me interesat e shqiptarëve çuan në këto arritje madhështore.

Kësisoj,

Një Kuvend i tillë na ndihmon që të bëhemi të vetëdijshëm për rëndësinë e njohjes së historisë së përpjekjeve të shqiptarëve pas pavarësisë deri në Kuvendin e Lushnjës për të formuar dhe hedhur bazat e shtetit të sotëm shqiptar.

Një Kuvend i tillë na ndihmon të kuptojmë peshën e kësaj vlere historike në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, për të marrë përsipër me dinjitet përgjegjësinë e kësaj peshe si trashëguesit dhe mbartësit themelor dhe të drejtpërdrejtë të shtetit të sotëm shqiptar.

Një Kuvend i tillë na ndihmon që të kuptojmë realitetin e trishtë të periudhës së pas pavarësisë dhe të asaj vështirësie në dhe për ngjizjen e shtetit shqiptar, por edhe realitetin që po jetojmë sot, për të zgjedhur me zgjuarsiri rrugë të reja për kapërcimin e ngërceve politik.

Një Kuvend i këtij formati na afron mundësinë që nëpërmjet fakteve të hidhet dritë mbi atë pjesë të të historisë sonë, e cila deri tani, jo se është lënë në harresë, por nuk ka ardhur as e plotë, as reale as me dritë hijet e saj

Së fundi, duke njohur historinë tonë të fillim shekullit të kaluar nëpër fatet që kërcënonin popullin dhe vendin tonë në përpjekjet cfilitës për shtetformimin e vet, ne do të dimë të bëhemi të vetëdijshëm për rolin tonë në kohët e reja.

Gjithë këto e të tjera na bëjnë ta shohim historinë sy më sy, sepse ta rishkruash historinë nuk do të thotë aspak ta qortosh atë.

QËLLIMI I KUVENDIT

1. Mbajtja e këtij Kuvendi ka si qëllim që të parashtrojmë fakte historike të hulumtuara nga studiues të ndryshëm, të cilat vërtetojnë përpjekjen e vët shqiptarëve për formimin e shtetit të vet.
2. Mbajtja e këtij kuvendi ka si qëllim që të ndricojë atë pjesë të historisë sonë, e cila ruan ende sende dhe gjera të pazbuluara, ku e shkuara është e detyrueshme të shkruhet, si ka qenë dhe si ka ndodhur, e vërtetë faktike e përlidhur, jo si dëshirë vetiake e tanishme sesi duhej të kishte qenë.

OBJETIVAT E KUVENDIT

1. Me patjetër na duhet të vazhdojmë të njohim dhe të shkruajmë të shkuarën.
2. Pse nevojitet? Pse është e domosdoshme? Çfarë duhet kërkuar në të? Si duhet shkruar? E shkuara nuk kthehet dhe nuk ndryshohet më?!
3. Na duhet të njohim njerëzit dhe ngjarjet e shkuara për t'i analizuar dhe matur me peshoren e çështjes shqiptare, se çfarë prodhuan njerëzit si individë apo grupe shoqërore me sjelljen dhe mentalitetin e tyre të at'hershëm, në formimin e shtetit shqiptar.

PËRFUNDIMI

1. Nga sinteza që iu bëjmë librave me burim autorë të huaj dhe vendas kuptojmë atë që nuk na është thënë se “Historitë shqiptare, janë një tjetër pohim se përpjekjet shqipëtare për shtet formim është aq vitale, saqë sapo zbulohet një dritare, një tjetër del pas saj, dhe lumë ai që di t'i hapi të gjitha.
2. Se ç'të shohësh?! Vëren sesi pas hapjes së tyre të shtrihet përpara një hapësirë edhe më e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme, e botuar dhe e skalitur me forma të ndryshme, e tretur ose e lënë në harresë, e dukur ose e padalluar.

TEMATIKAT E KUVENDIT

KUVENDI synon në:

1. Mbledhjen, zhvillimin dhe përhapjen e informacionit në shkallë kombëtare e ndërkombëtare në të gjitha aspektet e kërkimit dhe zbulimit të të dhënave mbi vlerat e të popullit shqiptar dhe bijve të vet për formimin dhe kristalizimin e shtetit shqiptar;
2. Promovimin dhe diskutimin mbi çështjet strategjike lidhur me periudhën më të vështirë të këtij kombi (Dhjetor 1912 - Janar 1920);
3. ofrimin dhe organizimin e edukimit në menaxhimin e koncepteve për këto vlera.

TEMAT E KUVENDIT

Tema e përgjithshme e KUVENDIT do të jetë “Rëndësia e njohjes së historisë së përpjekjeve të shqiptarëve pas pavarësisë deri në Kuvendin e Lushnjës për të formuar dhe hedhur bazat e shtetit të sotëm shqiptar” duke i dhënë kombit shqiptar ndjenjën e identitetit dhe të vazhdimësisë, duke ndihmuar kështu për promovimin e respektit për kulturën etj shtetformuese.

Tematikat e veçanta të KUVEND-it do të jenë:

1. SHQIPTARËT NË KAPËRXYELL TË PAVARSISËSË KOMBËTARE;
2. LUFTA E PARË BOTËRORE, PËRFSHIRJA, PJESËMARRJA DHE ROLI I SHQIPTARËVE NË TË;
3. MRETËRIMI I PRINC VIDIT DHE DRITË HIJET E SHQIPTARËVE NË QEVERISJEN E TIJ;
4. PUSHTIMET SERBE, BULLGARE E ITALIANE DHE ORVATJET PËR NDARJEN E FUNDIT TË SHQIPËRISË;
5. KONFERENCA E LONDRËS DHE FATI I SHQIPTARTËVE DHE SHQIPËRISË;
6. KONFERENCA E PARISIT DHE FATI I SHQIPTARTËVE DHE SHQIPËRISË;
7. KUVENDI I LUSHNJES DHE HAPAT DREJT SHTETFORMIMIT SHQIPTAR;
8. PREMISAT HISTORIKE PËR THIRRJEN E KONGRESIT KOMBËTAR TË LUSHNJES;
9. ORVAJTJET E QEVERISË SË DURRËSIT DHE PUSHTUESVE ITALIAN PËR NDALIMIN E KONGRESIT TË LUSHNJES DHE DËSHTIMI I TYRE;
10. PIKËPAMJET POLITIKO-SHOQËRORE TË GAZETËS “POPULLI” (1919-1920);

- 11.KONTRIBUTI I KOMITETIT MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS PËR MBAJTJEN E KONGRESIT TË LUSHNJES;
- 12.VEPRIMTARIA PATRIOTIKE E POPULLIT TË TIRANËS, GJIROKASTËR NË MBROJTJE TË KONGRESIT TË LUSHNJES;
- 13.LËVIZJA KOMBËTARE ÇLIRIMTARE NË QARKUN E BERATIT, NË VITET 1919-1920.
- 14.DESHTIMI I ORVAJTJES SË QEVERISË GREKE PËR PUSHTIMIN E KORÇËS NË GUSHT-SHTATOR 1920;
- 15.KONGRESI I LUSHNJES (21-31 JANAR 1920) AKTI THEMELOR KUSHTETUES PËR PAVARSINË E PLOTË TË SHQIPËRISË;
- 16.JEHONA KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE E VENDIMEVE TË KONGRESIT TË LUSHNJES;
- 17.KONGRESI ARSIMOR I LUSHNJËS;
- 18.SHPALLJA E TIRANËS, KRYEQYTET I SHQIPËRISË.

SESIONET E KUVENDIT

Kuvendi do të zgjasë së paku 2 (dy) ditë dhe do të përfshijë mënyrat e mëposhtme të prezantimit:

1. Pezantim me gojë;
2. Prezantim me anë të posterave;
3. Promovim libri;
4. Panair libri;
5. Ekspozitë.

PJESËMARRËS

1. Studiues nga vendbanimet shqiptare në Mal të Zi, Serbi, Maqedoni, Kroaci.
2. Akademikë dhe Albanologë nga Kroacia, Bosnja, Rumania, Bullgaria, Gjermania, Varshava, Francë, Sardenjë, Kreta, Vatra në SHBA, Itali.
3. Pedagogë e njohës të historisë së Shqipërisë e kudo.

TË FTUAR

Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministrat e Arsimit dhe të Kulturës Tiranë, Shkup, Prishtinë, Mali i Zi.

THIRRJA E PËRMBLEDHJEVE

Një përmbledhje (abstrakt) i zgjatur (së paku, gjysëm faqe, por jo më shumë se një faqe e plotë) duhet t'i dërgohet Komitetit Shkencor, jo më vonë se data 20 Tetor 2019. Në përmbledhje duhet të kihet parasysh që:

1. Përmbajtja e punimit (raste studimi të detajuara, të dhëna e artefakte të mbledhura, studime e referate apo artikuj të plotë, të cilët nuk janë prezantuar më parë në Shqipëri)
2. Autori kryesor, që duhet të përcaktohet qartë.
3. Çdo autor kryesor mund të parashtrojë, jo më shumë se dy përmbledhje;
4. Një format abstrakti duhet të shkarkohet nga faqja e internetit të KUVENDIT.
5. Gjuha zyrtare e KUVENDIT do të jetë shqipja dhe anglishtja, e cila do të përkthehet në mënyrë të njëkohshme për secilin nga pjesëmarrësit.
6. Të gjitha dokumentet duhet të shkruhen dhe të paraqiten në gjuhën shqipe dhe angleze, në Times New Roman, font 12, me hapësirë 1.3, me foto, skema ose shifra përkatëse që duhet të punohen në Corel për efekte editimi. Autorët pritët të marrin pjesë në KUVEND dhe të prezantojnë punimet e tyre.
7. Artikujt e pranuar do t'i komunikohen autorëve deri në fund të Nëntorit 2019. Nëse njoftimi nuk është marrë deri në fund të këtij muaji, autorët duhet t'i drejtohen Organizatorëve.
8. Punimi i plotë (maksimumi 10-12-15 faqe) duhet t'i dërgohet Organizatorëve, jo më vonë se data 20 Dhjetor 2019, i cili duhet të jetë në përputhje me rregullat e një artikulli shkencor, pra i gatshëm dhe direkt për botim. Artikulli i plotë duhet të përmbajë përmbledhjen, prej jo më shumë se 10 rreshta, fjalë kyçe, jo më shumë se 7-10 te tilla, hyrje, zhvillim sipas dy apo tre çështjeve, përfundime, dhe studime apo referenca mbështetëse të shpërndara në tekst dhe në fund të artikullit. Dhe më kryesorja, (se ndryshe artikujt nuk do të pranohen), do të jenë me drejtshkrimin më të mirë të mundshëm të shqipes zyrtare.
9. Pjesëmarrësit do t'iu krijohet mundësia e shkarkimit të materialit të plotë të studiuesit që janë të interesuar.
10. Punimet do të vlerësohen nga Komiteti Shkencor.
11. Do të ketë libër përmbledhjesh shqip-anglisht.
12. Do të ketë libër referatësh të KUVENDIT, me artikujt e mbajtur në KUVEND.

13. Prezantimi do të bëhet në Power Point, duke respektuar kohën prej 12-15 minuta përfshirë pyetje e përgjigje.

Të gjithë artikujt e pranuar për t'u prezantuar në KUVEND do të publikohen sipas procedurave në dispozicion në fillim të KUVENDIT.

TARIFAT E PJESËMARRJES PËR RELATORËT

Anëtar i shoqatave me fokus studime mbi Historinë	10 €
Jo-antarë	20 €
Institucionet shtetërore / Qeveria	50 €
Stafi i Universitetit	30 €
Publiku	0 €
Studentë të tjerë	1 €
Student i Universiteteve partnerë	0 €

THIRRJE PËR KUVENDISTËT/STENDAT E EKSPOZIMIT

1. Do të ftohen për pjesëmarrje Komunitetet fetare.
2. Fotoekspozitë me pamje nga Kongresi i Lushnjes.
3. Ekspozitë e librave të pjesëmarrësve në Kuvend, ku një ekspozitë jo e vogël do të mbahet së bashku me Konferencën, ku individë, organizata dhe institucione mund të shfaqin në formën e maketeve artefakte, figura me materiale shoqëruese.
4. Do të ftohen pjesëmarrësit të dhurojnë nga 5 kopje për çdo libër me temë Kuvendin e Lushnjes;
5. Stendat e ekspozimit do të jenë të disponueshme sipas tipologjive të mëposhtme, në mënyrë që kompanitë ekspozuese të zgjedhin atë më të përshtatshmen sipas nevojave të tyre të marketimit dhe sektorit që ata përfaqësojnë.
6. Për informacion të mëtejshëm ju lutemi kontaktoni sekretariatit organizativ.

PROFILI I VIZITORËVE

1. Përfaqësues të institucioneve arsimore dhe edukative, përfaqësues të institucioneve zyrtare dhe qeveritare, përfaqësues të bashkive dhe të administratave lokale, shoqata kulturore,

2. Mediat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare,
3. Nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mese, qytetarë që dëshirojnë të njehin historinë e kombit, të cilit i përkasin.

VENDNDODHJA

1. KUVEND MBARËKOMBËTAR “ PËRPPJEKJET E SHQIPTARËVE PAS PAVARSISË DERI NË KUVENDIN E LUSHNJES PËR TË FORMUAR BAZAT E SHTETIT TË SOTËM SHQIPTAR” do të mbahet në Lushnje, Ditë e Martë, 21Janar, 2020, Muzeu Lushnje.
2. Ajo do të mbahet në Sallën kryesore të Muzeut me kapacitet prej më shumë se 200 vende, duke përfshirë shërbimet profesionale të përkthimit; sistem regjistrimi audio dhe video.
3. **Ceremonia e Hapjes:** në Pallatin e Brigadave (Pallati Mbretëror) më dt. 20 Janar, 2020, si dhe me prani të të ftuarve nga Trupi Diplomatik; Autoritetet Shtetërore; Specialistët në fushën e Historisë dhe Kulturës, etj.

UDHËTIMI DHE VENDQËNDRIMI

1. Udhëtimi dhe vendqëndrimi: Delegatët, referuesit autorët e shkrimeve dhe pjesëmarrësit në Kuvend, do të kujdesen edhe vetë për udhëtimin dhe vendqëndrimin.
2. Në faqen zyrtare të kuvendit do të gjeni të afishuara informacione të hollësishme mbi zhvillimin e Kuvendit, oraret, referuesit, temat, si dhe sygjerime mbi udhëtimin dhe mundësitë e vendqëndrimit.
3. Delegatëve dhe pjesëmarrësve të Kuvendit do tju dërgohet një formular për tu plotësuar, me anën e të cilit bëhet aplikimi për pjesëmarrjen në Kuvend.

HAPJA E KUVENDIT

1. Kuvendi do të hapet në datën 20 Janar 2020 në Pallatin Mbretëror (mundësisht), ku do të shfaqet një film mbi Shqipërinë.
2. Të dhëna të tjera të hollësishme mbi këtë program do ti gjeni në faqen e tij zyrtare.

TURET E DELEGATËVE

Turet e delegatëve do të zhvillohen në qendrat historike e kuturore si Tiranë, Krujë e Durrës.

KËRKESAT E MËTEJSHME

- Një broshurë që paraqet një program të përkohshëm dhe përfshin formularin e aplikimit/pranimit, do t'u dërgohet të gjithë atyre që paraqesin një kërkesë.
- Formularët e aplikimit duhet të përmbajnë kushtet dhe tarifat e pjesëmarrjes.
- Për pyetje të mëtejshme dhe informacion ose regjistrim, ekspozitë, akomodim, etj., ju lutemi kontaktoni sekretariatën organizativ.

KOMITETI ORGANIZATIV

Dr. Stefan PINGULI	PRESIDENT I KUVENDIT Shoqata ILIRIUM SANCRUM
Prof. Asc.av.Astrit MEMIA	GJUHË - LETËRSI
Dr. Nail DRAGA	Gjeograf - historian
Prof. Inxh. Dashamir URUCI	Studiues
Prof. Lirim MUHAJ	GJUHËTAR
Lumturi RADKOCERI	studiuese
Manjola PERJA	studiuese
Albert XHOLI	SHKRIMTAR
Hasan ALIAJ	REVISTA RRËNJËT
Aulon KALAJA	ALEANCA PËR MBRUJTJEN E VLERAVE KOMBTARE

KOMITETI SHKENCOR

Prof. Dr. Selman SHEME	Gjeograf - historian
Dr. Niko FERRO	Historian
Fatbardha DEMI	Historiane
Prof. Nexhmi GANIU	Historian
Prof. Dr. Rexhep ABAZI	Studiues

Dr Adem AJVAZI	Historian
Nuri DRAGOI	Historian
Prof.dr. Saimir LOJLA	PUBLICIST/KANADA
Dr. Lutfi ALIAJ	MJEK, STUDIUS HISTORIAN
Dr. Mark PALNIKAJ	INXHINIER/STUDIUS HISTORIAN
Dr. Hysen KOCILLARI	Historian
Prof.dr. Xhemaledin SALIHU	SHOQ. TRASH. KRIJIMTARI KULTUR. PRESHEVË
Pajazit HAJZERI	Historian

SEKRETARIATI I KUVENDIT

Prof.asc. av. Sazan GURI	AKADEMIA ALTERNATIVE “RRËNJËT TONA”, AARRT
Ing. Dipl. Fred BALAJ	Studiues, AARRT
Ing. Jornis RINA	Antar, AARRT
Ing. Artenis DUKA	Antar, AARRT

INFORMACIONE PËR ORGANIZATORËT E KUVENDIT

1. AKADEMIA ALTERNATIVE “RRËNJËT TONA” ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi, konkretisht ligji nr. 8788, date 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurese”. Është themeluar me vullnet të lirë nga një grup anetarësh nismëtarë dhe është një organizatë, jofitimprurëse. Ajo është një organizim jo qeveritar, i pavarur nga partitë e organizatat politike dhe gëzon liri dhe autonomi të veprimit në përputhje me Statutin, Programin dhe Rregulloren e saj. Veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Anëtarët e parë themelues të Organizatës janë të gjithë ata individë, të cilët kanë nënshkruar deklaratën e themelimit dhe betimin për mbrojtjen e vlerave kombëtare. Qëllimi i veprimtarisë së Organizatës është të ndikojë në politikat strategjike të

shtetit Shqiptar që garantojnë mbrojtjen e vlerave kombëtare dhe në këtë kuadër saj të zhvillojë fushata periodike sensibilizuese për mbarë komunitetin shqiptar.

2. Shoqata **“ILIRIKUM SANCRUM”** ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi, konkretisht ligji nr. 8788, date 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurese”. Është themeluar me vullnet të lirë nga një grup anetarësh nismëtarë dhe është një organizatë, jofitimprurëse.

3. **“ALEANCA QYTETARE E MBRUJTJES SË VLERAVE KOMBËTARE**, shkurt AQMVK” ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi konkretisht ligji nr. 8788, date 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurese”, ligji nr. 8789, dt.07.05.2001. Aleanca Qytetare e Mbrujtjes së Vlerave Kombëtare është themeluar me vullnet të lirë nga një grup anetarësh nismëtarë dhe është një organizatë, jofitimprurëse. Ajo është një organizim jo qeveritar, i pavarur nga partitë e organizatat politike dhe gëzon liri dhe autonomi të veprimit në përputhje me Statutin, Programin dhe Rregulloren e saj. Organizata ka vulën dhe stemën e saj. Veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Anëtarët e parë themelues të Organizatës janë të gjithë ata individë, të cilët kanë nënshkruar deklaratën e themelimit dhe betimin për mbrojtjen e vlerave kombëtare. Qëllimi i veprimtarisë së Organizatës është të ndikojë në politikat strategjike të shtetit Shqiptar që garantojnë mbrojtjen e vlerave kombëtare dhe në këtë kuadër saj të zhvillojë fushata periodike sensibilizuese për mbarë komunitetin shqiptar.

4. QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE G & G GROUP

QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE - G & G Group ofron një kuadër të plotë të shërbimeve që mbulon fushën e Legjislacioniut, Mjedisit, Gjeoshkencës dhe Histori-gjuhësissë e etnokulturës.. Përgjegjësia për të menaxhuar sfidat e sotme dhe mbrojtjen e vlerave të kombit, kërkon zbatimin e njohurive të sotme shkencore.

KUJTESË

*Hapi i parë në likuidimin e një populli është
të fshish kujtesën e tij historike.*

*Shkatërrojnë librat e tij, kulturën e tij,
historinë e tij.*

*Atëherë vini dikë të shkruajë libra të rinj, të
krijojë një kulturë të re, të shpikë një histori
të re.*

*Para se të kalojë shumë kohë kombi do të
harrojë se çfarë është dhe çfarë qe.*